

URDHËR
Nr. 154/1, datë 29.4.2022

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË, NË
MJEDISËT E HAPURA DHE NË TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; të shkronjës “b”, nenit 15, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e shitjes dhe të tregtimit të shpendëve të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla, në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Shkodër, Shijak dhe Durrës.
 2. Ndalimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë nga ferma në fermë dhe nga ferma në tregjet e kafshëve të gjalla, në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Shkodër, Shijak dhe Durrës.
 3. Lejimin e lëvizjes së shpendëve të gjallë, vetëm për në thertore, në bashkitë Lushnjë, Divjakë, Shkodër, Shijak dhe Durrës, të shoqëruar me dokumentacionin e parashikuar, sipas legjislacionit në fuqi.
 4. Urdhri nr. 154, datë 1.4.2022, “Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla”, shfuqizohet.
 5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Programeve të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Zhvillimit Rural dhe Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca